



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Bujar Ajeti (Gjermizi)**, më datë **09.07.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “1. Verifikimin e nevojave të sigurimit nëpërmjet marrjes së informacionit për hetimet e kryera nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përse i përket procedimit penal në ngarkim të shtetasit Bujar Ajeti (Gjermizi); 2. Zëvendësimin e masës së sigurimit të “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale në masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penal.”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Elsa Ulliri, bazuar në nenin 246/6 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **432**, datë **29.07.2024**, vendosi:

1. Verifikimin e nevojave të sigurimit dhe vazhdimi i zbatimit të masës së sigurimit “**Arrest në burg**”, caktuar ndaj shtetasit **Bujar Ajeti** me anë të vendimit Nr.124, datë 17.11.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.

Tiranë, më datë 29.07.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar